KËRKESË
Nr. 4270/2, datë 27.12.2017

PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIMI I BLLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN "KADRI QYSTRI"", LUSHNJË

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemimi i bllokut të banimit në lagjen "Kadri Qystri"", Lushnjë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për llogaritjen e vlerës së truallit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 1,281,588 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

VLERA E SHPRONËSIMIT TË TRUALLIT TË
Z. THOMA SEMINI NË LAGJEN "KADRI QYSTRI", ZONA KADASTRALE 8571

Investitori: Bashkia Lushnjë

Nr.	Nr. i pasurisë	Emër, mbiemër	Zona kadas.	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Konfirmimi nga ZVRPP-ja
1	11.183	Thoma Semini	8571	Truall	m^2	132	9709	1,281,588	Shkresa nr. 1922/1, datë 20.3.2017
SHUMA TOTALE								**1,281,588**	